



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I STABILITETIT FINANCIAR

Raport¹

mbi ecurinë e treguesve që do të monitorojë Banka e Shqipërisë, në kuadër të procesit të de- euroizimit

Shkurt 2019

¹ Ky raport del në kuadër të parashikimeve në Memorandumin e Bashkëpunimit mes Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Bankës së Shqipërisë dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare “Për zgjerimin e përdorimit të monedhës kombëtare në sistemin financiar dhe në ekonominë shqiptare” nënshkruar në 18.04.2017 dhe publikuar në adresën e internetit:

https://www.bankofalbania.org/web/pub/memorandumi_gksf_9384_1.pdf

Përmbajtje

I	Hyrje	3
II	Përmbledhje	5
III	Ecuria e treguesve	6
IV	Konkluzion	12
Aneksi I: Veprime rregullative të mëparshme që ndikojnë në drejtim të de-euroizimit.		13

I Hyrje

Në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë dhe me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, nënshkruar në datën 18 prill 2017, Banka e Shqipërisë ndërmori një paketë masash konkrete për të stimuluar përdorimin e monedhës vendase. Paketa e masave, e cila u miratua me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në shkurt 2018, përbëhet nga tre elemente kryesore: i) diferencimin e rezervës së detyrueshme për detyrimet në valutë; ii) kërkesat më të larta për treguesit e likuiditetit në valutë; iii) ndërgjegjësimin e huamarrësve për rrezikun që paraqet kredia në valutë.

- i. Për të rritur peshën e monedhës vendase dhe njëkohësisht zgjerimin e maturitetit në strukturën e detyrimeve të sistemit bankar, **Banka e Shqipërisë vendosi të diferencojë normën e rezervës së detyrueshme²**, për kategoritë e përfshira në bazën e rezervës së detyruar, si vijon:
- 7.5% (nga 10% që ishte më parë) për detyrimet në lekë që kanë një afat maturimi jo më të gjatë se 12 muaj;
 - 5% (nga 10% që ishte më parë) për detyrimet në lekë që kanë një afat fillestar më të gjatë se 12 muaj deri në 2 vjet;
 - 12.5% (nga 10% që ishte më parë) për detyrimet në valutë kur këto zënë nën 50% te totalit;
 - 20% (nga 10% që ishte më parë) për pjesën e detyrimeve në valutë mbi 50% te totalit.

Monitorimi i efekteve të masës (i) bëhet nëpërmjet treguesve në vijim:

- *raportit të depozitave në valutë të zhveshur nga efektet e kursit të këmbimit ndaj totalit të depozitave;*
- *raportit të depozitave deri në një vit në lekë ndaj totalit të depozitave në lekë;*
- *ecurisë së strukturës së borxhit publik.*

- ii. Për administrimin më të kujdesshëm të rrezikut të likuiditetit, **Banka e Shqipërisë vendosi të rrisë kërkesën minimale rregullative për aktive likuide në valutë³** në nivelin 20% të detyrimeve afatshkurtra. Për aktivet likuide në lekë, niveli i raportit ruhet në nivelin aktual prej 15%.

² Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 13, datë 07.02.2018, “Për miratimin e normës së rezervës së detyruar mbajtur në Bankën e Shqipërisë nga bankat”.

³ Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.14, datë 07.02.2018, “Për një ndryshim në rregulloren për administrimin e rrezikut të likuiditetit”.

Monitorimi i efekteve të masës (ii) do të bëhet nëpërmjet treguesit në vijim:

- *raporti i aktiveve likuide në valutë ndaj detyrimeve afatshkurtra në valutë, të zhveshura nga efekti i kursit të këmbimit.*

iii. Për rritjen e **ndërgjegjësimit të huamarrësve në lidhje me rrezikun e kursit të këmbimit**, Banka e Shqipërisë i ka kërkuar bankave⁴ që:

- në rastet kur klienti aplikon për kredi në monedhë të ndryshme nga monedha që ka të ardhurat, bankat t'i propozojnë huamarrësit një kredi alternative në të njëjtën monedhë me të ardhurave e tij, si dhe ta pajisin atë me një shembull konkret se si ndryshon kësti i kredisë në rastin e nënçmimit të lekut dhe/ose të rritjes së normës së interesit (me vlera të përcaktuara);
- të përfshijnë në kontratat e reja të kredisë në valutë (apo ato që ristrukturohen rishtas), opsionin për përdorimin e mekanizmave që zbusin rrezikun e tregut për kredimarrësin, në rastin kur plotësohen kushtet që janë të dakorduara nga banka dhe huamarrësi.

Monitorimi i efektit të masave (iii) bëhet nëpërmjet treguesve në vijim:

- *kredia në valutë ndaj totalit të portofolit, i zhveshur nga efekti i kursit të këmbimit;*
- *kredia në valutë e pambrojtur nga kursi i këmbimit ndaj totalit të kredive në valutë, i zhveshur nga efekti i kursit të këmbimit;*
- *rezultatet e vrojtimit të euros që përgatitet një herë në vit nga Banka Qendrore e Austrisë (vetëm në raportin e muajit korrik).*

Efikasiteti i masave monitorohet përmes treguesve dhe vlerësohet në bazë të ndryshimit në nivelin e euroizimit të sistemit financiar, para dhe pas implementimit të tyre. Rezultatet e këtij vlerësimi, si dhe gjykimi mbi përshtatshmërinë e masave për arritjen e objektivit, që është nxitja e përdorimit më të madh të monedhës kombëtare në ekonomi, do të komunikohen çdo gjashtëmuajor, përmes publikimit të këtij raporti.

Sikurse theksohet në Memorandum, synimi i Strategjisë nuk është arritja e nivelit zero të përdorimit të monedhave të huaja, pasi niveli i hapjes së ekonomisë sonë me vendet partnere tregtare nënkupton prezencën e rëndësishme të monedhave të tjera të huaja në sistemin tonë financiar. Objektivi është pakësimi i përdorimit të monedhave të huaja deri në një nivel që konsiderohet i natyrshëm për një ekonomi të ngjashme me atë shqiptare.

⁴ Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 15, datë 07.02.2018, "Për disa ndryshime në rregulloren mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare".

II Përmbledhje⁵

Gjatë gjashtëmuorit të dytë 2018, vërehet një zhvendosje e lehtë drejt niveleve më të ulëta të rrezikut në shumicën e treguesve kryesorë, por një vlerësim mbi ndikimin e masave të de-euroizimit mbetet i parakohshëm.


Krahasuar me fundin e qershorit 2018, vërehen ndryshimet në vijim:

Depozitat – Në fund të dhjetorit 2018, depozitat në valutë shënuan rritje të lehtë në nivelin 53.6% të depozitave të sektorit privat. Ndërsa depozitat deri në një vit në monedhën vendase kanë njohur rënie në nivelin 86.9%;

Likuiditeti – Në fund të dhjetorit 2018, aktivet likuide në valutë ndaj pasiveve afatshkurtra në valutë, shënuan nivelin 36.8%, me një rritje prej 4.4 pikë përqindjeje. Kjo rritje e konsiderueshme e treguesit është përcaktuar nga rritja e aktiveve likuide, ndërkohë që pasivet afatshkurtra kanë njohur rënie të lehtë;

Kreditë – Në fund të dhjetorit 2018, 56.6% e portofolit të kredive është në valutë. Kreditë e pambuluara ndaj kursit të këmbimit përbëjnë 43.2% të kredive në valutë.

Grafik 1. Treguesit kryesorë për monitorimin e nivelit të përdorimit të valutës në sektorin bankar shqiptar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shënim: Për secilin tregues, niveli i rrezikut është përcaktuar duke iu referuar një pragu krahasues. Për treguesit e 'depozitave në valutë ndaj totalit të depozitave' dhe 'kreditë në valutë ndaj totalit të tepricës së kredisë', pragu krahasues është niveli prej 30%, sipas gjykimit ekspert. Për vlera nën 30% të këtyre treguesve, niveli i rrezikut konsiderohet 'i ulët' (ngjyra e gjelbër). Për treguesin e 'aktiveve likuide në valutë ndaj pasiveve afatshkurtra në valutë', pragu

⁵ Treguesit e monitoruar në këtë raport, paraqiten të zhveshur nga efekti tremujor i luhatjeve në kursin e këmbimit të monedhës kombëtare ndaj monedhave kryesore të huaja (euro dhe dollar amerikan). Për matjen e efektit të kursit në portofolin e kredive të secilës bankë është përdorur formula në vijim: $X_t - X_{t-1} - (X_t/K_t - X_{t-1}/K_{t-1}) * K_{t-1}$. Ku X përfaqëson vlerën në monedhën vendase, K është kursi këmbimit i shprehur në lekë për njësi të valutës, dhe t është periudha e shprehur në tremujor.

krahasues llogaritet duke i shtuar një devijim standard të serisë kohore kufirit rregullativ prej 20%. Për vlera më të ulëta se ky prag krahasues, treguesi sinjalizon 'nivel të lartë' të rrezikut. Për treguesin e 'depozitave me afat deri në një vit në lekë ndaj totalit të depozitave në lekë', pragu krahasues është përcaktuar sipas gjykimit ekspert në nivelin 60%.


III Ecuria e treguesve

Në këtë kapitull përshkruhet ecuria e treguesve të listuar në hyrje të materialit. Paraqitja e treguesve pa efektet e kursit të këmbimit synon matjen vetëm të ndikimit të masave pa ndikimin e ecurisë së kursit. Ashtu siç është paraqitur në vijim, lajmërimi i paketës së masave nuk ka pasur efekt të menjëhershëm mbi treguesit e analizuar.

Ecuria në Depozita

Në fund të gjashtëmujorit të dytë 2018, depozitat në valutë shënuan 53.6% të totalit të depozitave të klientëve, krahasuar me 53.2% që ishin në fund të qershorit 2018 dhe 52.3% një vit më parë. Rritja e lehtë prej 0.4 pikë përqindjeje gjatë këtij gjashtëmujori është në linjë me vlerat historike të treguesit që është luhatur rreth nivelit 53%.

Grafik 2. Raporti i depozitave në valutë ndaj totalit të depozitave, për sistemin bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Për sa i përket shpërndarjes së treguesit të depozitave në valutë, edhe për gjashtëmujorin e dytë 2018, vërehet se gjysma e bankave të sistemit bankar e kanë këtë tregues mbi 50%, duke i bërë ato subjekt të normës më të lartë të rezervës së detyrueshme (20%) për pjesën e depozitave në valutë mbi nivelin 50%. Si rezultat, pritshmëritë janë që raporti i depozitave në valutë ndaj depozitave të përgjithshme, për bankat që e kanë këtë raport mbi vlerën 50%, të vijë në rënie.

Aktualisht rezulton se 7 nga 14 banka⁶ të sistemit janë mbi nivelin 50%, me nivelin maksimal prej 61.5%. Përsa i takon vlerës maksimale të shënuar nga bankat e sistemit,

6 Gjatë vitit 2018, me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, u miratuan riorganizimi juridik nëpërmjet bashkimit me përthithje të dy bankave të sistemit duke reduktuar numrin total në 14.

ajo ka njohur rënie, krahasuar me një vit më parë. Për më shumë informacion referojuni grafikut në vijim.


Grafik 3. Shpërndarja e treguesit të depozitave në valutë ndaj totalit të depozitave, për bankat e sistemit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pjesë e paketës së masave është dhe reduktimi i kërkesës për rezervë të detyruar në lekë, për depozitat që janë me maturim mbi një vit. Në fund të dhjetorit 2018, depozitat deri në një vit në monedhën vendase ishin 86.9% e totalit të depozitave në lekë, nga 87.4% në fund të qershorit 2018 dhe 86.4% një vit më parë.


Grafik 4. Raporti i depozitave deri në një vit në lekë ndaj totalit të depozitave në lekë, për sistemin bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shpërndarja e treguesit të mësipërm sipas bankave paraqitet me ngushtim të kuartilit të parë, ku minimumi është rritur nga 61.8% në fund të qershorit 2018, në 70.9% në fund të dhjetorit 2018. Nga ana tjetër, vërehet rënie e mesatares dhe medianës së vlerave të treguesit për bankat e sektorit, duke sinjalizuar në këtë mënyrë një prirje pozitive. Rritja e depozitave mbi një vit ndihmon në përmirësimin e qëndrueshmërisë së burimeve të financimit të sektorit bankar, e cila gradualisht ndikon në strukturën e investimeve në aktiv të bilancit të sektorit.

Grafik 5. Shpërndarja e raportit të depozitave deri në një vit në lekë ndaj totalit të depozitave në lekë, për bankat e sistemit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ecuria në Aktivitet Likuide

Sistemi financiar shqiptar vijon të karakterizohet nga nivele të kënaqshme të likuiditetit, konkretisht të treguesit “aktiveve likuide ndaj pasiveve afatshkurtra.” Në nivel sektori, ky tregues ka ruajtur vlerat mbi limitet rregullatore, si për monedhën vendase ashtu edhe për valutën, duke ndikuar pozitivisht në shëndetin e sistemit financiar.

Në lidhje me shpërndarjen e treguesit për valutën sipas bankave të sistemit, vërehet se të gjitha bankat paraqiten mbi nivelin e kërkuar rregullator (i cili, si pjesë e masave të marra në shkurt 2018, u rrit nga 15% në 20%). Ecuria e vlerës mesatare të raportit nuk ka treguar ndryshime të rëndësishme gjatë periudhës, ndërkohë që është rritur vlera maksimale e treguesit në nivelin 66.9%. Për më shumë në lidhje me shpërndarje e treguesit sipas bankave të sistemit, referojuni grafikut në vijim.

Grafik 6. Shpërndarja e treguesit të aktiveve likuide në valutë ndaj pasiveve afatshkurtra në valutë, për bankat e sistemit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ecuria në Kredi

Në stokun e kredive të sistemit financiar mbizotërojnë kreditë në valutë, të cilat kanë shënuar nivelin 56.6% në fund të dhjetorit 2018, me rënie në krahasim me fundin e gjashtëmuajorit të kaluar dhe i pandryshuar me një vit më parë.


Grafik 7. Raporti i kredive në valutë ndaj totalit të kredive, për sistemin bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në nivel bankash konstatohet shpërndarje e gjerë e treguesit, ku në fund të dhjetorit 2018, treguesi është luhatur midis vlerave 41.1% deri në 82.11%. Përsa i përket vlerës maksimale ka pasur një rënie të konsiderueshme në nivelin 82.11%, nga 88.05% që shënonte gjashtë muaj më parë dhe 88.74% një vit më parë. Megjithëse mediana ka ruajtur vlera të përafërta, mesatarja ka njohur rënie të lehtë, duke shënuar 60.8% në fund të dhjetorit 2018, nga 62.7% që shënonte në fund të qershorit 2018 dhe 61.85% një vit më parë. Rënia e mesatares së sistemit pasqyron faktin që, në përgjithësi, ky tregues ka njohur rënie për bankat e sistemit.


Grafik 8. Shpërndarja e raportit të kredive në valutë ndaj totalit të kredive, për bankat e sistemit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ndër kreditë në valutë, kreditë më të ekspozuara ndaj rrezikut të kursit të këmbimit janë ato ku të ardhurat e subjektit huamarrës janë në monedhë të ndryshme nga monedha e kredisë (kreditë e pambuluara ndaj rrezikut të kursit të këmbimit). Në fund të dhjetorit 2018, këto kredi përbëjnë 43.2% të kredive në valutë, krahasuar me 42.8% në fund të qershorit 2018 dhe 43.5% një vit më parë. Ecuria e treguesit është ndikuar nga rritja e numëruesit dhe rënia e emëruesit. Me gjithë këtë rritje të lehtë krahasuar me fundin e qershorit 2018, treguesi gjendet pranë vlerave më të ulëta historike.


Grafik 9. Raporti i kredive në valutë të pambrojtura ndaj rrezikut të kursit të këmbimit si përqindje e totalit të kredive në valutë, për sistemin bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shpërndarja e treguesit të kredive të pambrojtura ndaj rrezikut të kursit të këmbimit për bankat e sistemit paraqitet në grafikun në vijim. Konstatohet që shpërndarja e treguesit është zgjeruar gjatë gjashtëmujorit të dytë 2018. Vlera maksimale ka arritur nivelin 82.4%, nga 69.9% që shënonte në fund të qershorit 2018 dhe 69.6% një vit më parë. Gjysma e tyre janë midis 44.1% dhe 82.4% të kredive përkatëse në valutë. Shpërndarja e gjerë e treguesit reflekton faktin që disa banka janë më të ekspozuara ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit.

Grafik 10. Shpërndarja e peshës së kredive në valutë të pambrojtura ndaj rrezikut të kursit të këmbimit ndaj totalit të kredive në valutë, për bankat e sistemit



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Ecuria në Borxhin Publik

Në fund të shtatorit 2018, vërehet:

- 1) rritje e peshës së letrave me vlerë të borxhit (titujve) me maturitet më të gjatë se 12 muaj;
- 2) rënie e peshës së detyrimeve në valutë të qeverisë shqiptare.

Rënia e detyrimeve në valutë dhe rritja e atyre në monedhën vendase, ndikon pozitivisht në drejtim të de-euroizimit. Në fakt, krahasuar me fundin e marsit 2018, pesha e borxhit publik në monedhën vendase u rrit me 0.6 pikë përqindje, duke shënuar 52.5% në fund të tremujorit të tretë 2018. Borxhi i brendshëm është kryesisht në lekë, ndërsa borxhi i jashtëm është në valuta të ndryshme, por kryesisht në euro.

Grafik 11. Ecuria e borxhit publik në lekë dhe valutë, si dhe pesha e borxhit publik në lekë ndaj totalit




Burimi: Të dhënat nga faqja zyrtare e Ministrisë së Financave, përpunuar nga Banka e Shqipërisë.

Ecuria në Kursin e Këmbimit

Gjatë gjashtëmujori të dytë 2018, monedha vendase ka njohur forcim kundrejt euros, duke vijuar prirjen e lehtë forcuese, por me ritëm më të ngadalësuar. Kundrejt dollarit amerikan, leku është nënçmuar lehtë, duke reflektuar përgjithësisht ecurinë e kursit të këmbimit të dollarit amerikan në tregjet ndërkombëtare të këmbimit.

Grafik 12. Ecuria e kursit të këmbimit të lekut ndaj dy valutave kryesore



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Stabiliteti makroekonomik shoqërohet zakonisht me qëndrueshmëri të kursit të këmbimit. Në përgjithësi dhe në afat të gjatë, kjo ecuri duhet të mbështesë besimin e publikut në monedhën kombëtare dhe të rrisë përdorimin e saj nga agjentët e ekonomisë. Nga ana tjetër, prirja afatgjatë nuk përjashton luhatshmërinë e kursit të këmbimit në periudha të caktuara, duke ndikuar në vlerën e kursimeve dhe të huamarrjes në valutë. Nga ky këndvështrim, kjo luhatshmëri vlen për të sinjalizuar përdoruesit e valutës mbi rreziqet që shoqërojnë vlerën e ekspozimit të tyre dhe nevojën për vlerësimin e kujdesshëm dhe ndërmarrjen e veprimeve për zbutjen e këtyre rreziqeve.

IV Konkluzion

Bazuar në ecurinë e treguesve të përzgjedhur gjatë gjashtëmujorit të dytë 2018, vërehet se lëvizjet në shumicën e tyre sugjerojnë një ulje të përdorimit të valutës në sistemin financiar. Megjithatë, madhësia e lëvizjes së vlerave të treguesve, në të gjitha rastet, është shumë e vogël. Në tërësi, vlerat e treguesve mbeten të shmangura ndjeshëm nga vlerat mesatare të treguesve për vende me ekonomi të ngjashme si Shqipëria. Në këto kushte, është e parakohshme dhënia e një vlerësimi për ndikimin e masave të de-euroizimit të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, dhe rishikimi i rregullt i tyre mbetet i rëndësishëm.

Sistemi financiar shqiptar vijon të paraqesë nivele të larta të euroizimit, të cilat reflektojnë përdorimin e valutës në shkallë të gjerë në ekonominë shqiptare. Në këto kushte, marrja e masave për të kontrolluar dhe ulur këto nivele, në mënyrë graduale, është e nevojshme. Për këtë arsye, mbështetur në Memorandumin përkatës të Bashkëpunimit, Banka e Shqipërisë fton edhe palët e tjera nënshkruese të vijojnë aplikimin e masave për tregjet dhe instrumentet që mbikëqyrin respektivisht, me qëllim nxitjen e përdorimit më të gjerë të monedhës vendase në ekonominë shqiptare.

Aneks I: Veprime rregullative të mëparshme që ndikojnë në drejtim të de-euroizimit

Nr.	Masa	Data e adoptimit/e zbatimit	Përshkrim
1.	Kufizimi i huave në valutë të pambrojtura nga rreziku i kursit të këmbimit	Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 62, datë 14.09.2011, “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja”, neni 15	Huatë në valutë, të dhëna për huamarrësit e pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit (pra ku të ardhurat e huamarrësit janë në lekë), nuk duhet të kapërcejnë nivelin 400% të vlerës së kapitalit rregullator të bankës. Çdo vlerë mbi këtë nivel, zbritet nga vlera e kapitalit rregullator.
2.	Kërkesa minimale për aktive likuide në valutë	Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës nr. 75, datë 26.10.2011, dhe nr. 28, datë 27.03.2013	Vendosja e një kërkesë minimale për vlerën e raportit të aktiveve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra, në nivelin 15%, e zbatueshme veçmas për lekun dhe për valutat kryesore (euro, dollar amerikan), dhe në total në nivelin 20%.
3.	Kërkesa më e lartë për kapital, lidhur me huatë në valutë të pambrojtura nga rreziku i kursit të këmbimit	Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 48, datë 31.07.2013, “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”	Huatë në valutë ndaj huamarrësve të pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit, ponderohen me koeficient më të lartë rreziku (150%), për qëllime të llogaritjes së treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit të bankës.